

Treguesit demografikë

Tremujori II – 2020

Tiranë, më 12 gusht 2020:

NUMRI I LINDJEVE DHE VDEKJEVE GJATË TREMUJORIT TË DYTË 2020 MUND TË MOS REFLEKTOJË REALITETIN, PASI PËR SHKAK TË SITUATËS SË COVID-19, MOS RAPORTIMET NËPËR ZYRAT E GJENDJEVE CIVILE NË TË GJITHË SHQIPËRINË PËR NUMRIN E LINDJEVE DHE VDEKJEVE MUND TË MOS JENË REFLEKTUAR NË REGJISTRAT PËRKATËS.


KËSISOJ, TË DHËNAT DO TË JENË OBJEKT RISHIKIMI PËR 2020 DHE DO TË RIVLERËSOHEN.

Numri i lindjeve për tremujorin e dytë 2020 është 6.124, duke shënuar një rënie me 8,0 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2019.

Numri i vdekjeve për tremujorin e dytë 2020 rezulton 4.989, duke shënuar një rënie prej 3,1 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2019.

Gjatë tremujorit të dytë 2020, numri i lindjeve tejkalon me 1.135 numrin e vdekjeve.

Fig. 1: Shtesa natyrore e popullsisë




Për publikim: 12 gusht 2020

Në tremujorin e dytë 2020 shtatë qarqe të vendit kanë shënuar shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në pesë qarqe, shtesa natyrore e popullsisë ishte negative.

Në tremujorin e dytë 2020 vlera më e lartë e shtesës natyrore regjistrohet në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 709 numrin e vdekjeve, ndërsa ajo më e vogël regjistrohet në qarkun e Vlorës, ku vdekjet tejkalojnë me 80 numrin e lindjeve.

Fig. 2: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T2 – 2020



Lindjet

Në tremujorin e dytë 2020 dy qarqe të vendit kanë shënuar rritje të numrit të lindjeve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ndërsa në dhjetë qarqe ka pasur rënie.

Në tremujorin e dytë 2020 numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 1.973 lindje, ndërsa ai më i vogël në qarkun e Gjirokastrës, me 121 lindje.

Rritjen më të madhe në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të dytë 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 e ka qarku i Gjirokastrës me 5,2 %, rënien më të madhe e ka qarku i Kukësit, me 37,0 %.

Tab. 1: Lindjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	II - 19	III - 19	IV - 19	I - 2020**	II- 2020**
	Shqipëria	6.655	7.739	7.910	6.126	6,124
1	Berat	251	322	316	246	231
2	Dibër	400	424	416	298	364
3	Durrës	703	842	866	649	633
4	Elbasan	678	762	761	594	592
5	Fier	555	694	755	556	554
6	Gjirokastrë	115	122	160	91	121
7	Korçë	443	461	439	380	425
8	Kukës	270	279	316	146	170
9	Lezhë	272	358	362	314	277
10	Shkodër	420	502	557	422	397
11	Tiranë	2.224	2.509	2.525	2.059	1,973
12	Vlorë	289	437	397	284	286
	<i>Të panjohur*</i>	35	27	40	87	101

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon¹

**Të dhëna paraprake

Vdekjet

Në tremujorin e dytë 2020 shtatë qarqe të vendit kanë shënuar rënie të numrit të vdekjeve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ndërsa pesë qarqe kanë shënuar rritje.

Në tremujorin e dytë 2020 numri më i vogël i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 117 vdekje, ndërsa ai më i lartë në qarkun e Tiranës, me 1.264 vdekje.

Rënien më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të dytë 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 e ka qarku i Beratit, me 24,4 %, ndërsa rritjen më të madhe në përqindje e ka qarku i Gjirokastrës, me 9,9 %.

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim:

<http://www.instat.gov.al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

Tab. 2: Vdekjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	II - 19	III - 19	IV - 19	I - 2020**	II- 2020**
	Shqipëria	5.149	5.006	5.421	6.115	4,989
1	Berat	336	258	262	357	254
2	Dibër	216	224	219	230	193
3	Durrës	452	437	579	526	445
4	Elbasan	488	499	460	618	496
5	Fier	540	577	569	692	537
6	Gjirokastër	161	179	191	214	177
7	Korçë	548	451	513	628	472
8	Kukës	127	132	124	134	117
9	Lezhë	231	207	251	283	249
10	Shkodër	402	408	442	479	417
11	Tiranë	1.261	1.246	1.378	1.499	1,264
12	Vlorë	381	380	430	454	366
	<i>Të panjohur*</i>	6	8	3	1	2

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon

**Të dhëna paraprake

Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

INSTAT sipas metodologjisë që ndjek, numëron numrin e lindjeve sipas datës së ndodhjes së ngjarjes dhe jo sipas datës së regjistrimit të kësaj ngjarjeje në zyrat e gjendjes civile.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë, në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, sipas karakteristikave bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

INSTAT sipas metodologjisë që ndjek, numëron numrin e vdekjeve sipas datës së ndodhjes së ngjarjes dhe jo sipas datës së regjistrimit të kësaj ngjarjeje në zyrat e gjendjes civile

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë, në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).